



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 shkurt 2018
Nr. Ref.: RK 1193/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI88/17

Parashtrues

Slobodan Gavrić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 55/2017,
të 3 prillit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Slobodan Gavrić, banor i Beogradit, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Dejan Vasić, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 55/2017, të 3 prillit 2017, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AKRP. nr. 591/2016, të 15 nëntorit 2016, dhe Aktgjykimit PKR. nr. 392/15, të Gjykatës Themelore të 29 qershorit 2016.
3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 55/2017, iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 24 prill 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet se ka shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me paragrafin 2, të nenit 5 [Gjuhët] dhe paragrafin 2, të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 2 gusht 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 4 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 8 gusht 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj autorizim të nënshkruar për përfaqësuesin e tij ligjor. Të njëjtën datë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 4 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin e nënshkruar për përfaqësuesin e tij ligjor.
10. Më 10 janar 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 25 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës ishte duke transportuar eksplozivë nga Beogradi në Prishtinë, me pretendimin se kishte për qëllim t'ia shiste një pale të tretë. Në Prishtinë ai u ndalua dhe u kontrollua nga policia, e cila në

makinën e tij gjeti një qese që përmbante 23 paketa eksploziv me një peshë totale prej 12.219 kilogram.

12. Më 10 korrik 2015, Prokurori Special i Shtetit (në tekstin e mëtejshëm: Prokurori) ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale të *“Përgatitjes së veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”* siç parashihet në nenin 144, paragrafët 1 dhe 3, në lidhje me nenin 135, paragrafi 1, pika 1.9, të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK).
13. Më 29 qershor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi PKR. nr. 591/2016) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprat penale me të cilat ishte akuzuar dhe e dënoi atë me burgim prej 13 (trembëdhjetë) vjetësh.
14. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore thuhet që parashtruesi i kërkesës *“ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe penalisht përgjegjës, se e kreu me dashje, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe e ka dashur kryerjen e kësaj vepre penale”*.
15. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të *“shkeljes esenciale të dispozitave ligjore të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënim”*. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës pretendonte se Gjykata Themelore nuk kishte vërtetuar mjaftueshëm *“dashjen”* e tij për të kryer veprën penale, si pjesë përbërëse e veprës penale për të cilën ishte dënuar.
16. Më 15 nëntor 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 591/2016) aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit dhe hodhi poshtë bazat e tjera të ankesës. Gjykata e Apelit uli dënimin nga 13 (trembëdhjetë) vjet në 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim.
17. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit thuhet se *“aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashtruara në ankesë (...) dhe që do të kishte ndikuar në ndryshimin e aktgjykimit dhe ricilësimit e veprës penale”*.
18. Parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të *“shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10, në lidhje me nenin 232, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i KPPK) dhe shkeljes së ligjit penal”*.
19. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi se Gjykata e Apelit kishte shkelur Kodin Penal, sepse *“është shkelur neni 2, paragrafi 3 i KPK-së, pasi në këtë rast duhet të jetë zbatuar Kodi Penal në versionin e gjuhës serbe, me të cilin veprimet e të dënuarit nuk paraqesin figurën ligjore të veprës penale sepse neni 144.3 në versionin e gjuhës serbe nuk parasheh futjen e materialeve në territorin e Kosovës”*.
20. Më 3 prill 2017, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML nr. 55/2017) e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.

21. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme arsyetoi se *“gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj i ka arsyetuar të gjitha faktet relevante në këtë çështje juridike edhe përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale (faqja 15 e aktgjykimit), të cilin e pranon edhe kjo Gjykatë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai ishte dënua për *“sjelljen e eksplozivëve në Kosovë”* në bazë të versionit të gjuhës shqipe të nenit 144.3 të KPK-së, ndërsa versioni në gjuhën serbe i nenit 144.3 nuk i referohet sjelljes së eksplozivëve në Kosovë. Si serb, parashtruesi i kërkesës pretendon se duhet të aplikohet vetëm versioni i ligjit në gjuhën serbe.
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo shkel nenin 5 (1) të Kushtetutës, sepse edhe gjuha shqipe edhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“neni 5, paragrafi 1 i Kushtetutës së RK-së përcakton se gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Neni 144, paragrafi 3 të versionit të KP-së në gjuhën serbe thotë: “Svako lice koje sa teritorije Republike Kosovo iznese eksplozive, oružja ...” (“Kushdo që dërgon jashtë territorit të Republikës së Kosovës armë, eksploziv ...”). Domethënë, versioni i ligjit në gjuhën serbe nuk parashikon se si veprim i kryerjes mund të jetë importi, por vetëm eksporti”*.
25. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se, duke aplikuar versionin në gjuhën shqipe të KPK-së, me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e tij për barazi para ligjit, siç garantohet me nenin 24 (2) të Kushtetutës, pasi që *“gjithashtu me nenin 24, paragrafi 2 të Kushtetutës parashikohet ndalimi i diskriminimit mbi këtë bazë”*.
26. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *“marrjen e vendimit ndryshues përkitazi me cilësimin e veprës penale dhe zvogëlimin proporcional të dënimit”*.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit, dhe parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

30. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

31. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(...)

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(...)

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Gjykata vëren se parashtruesi pretendon se ai ishte dënuar për një vepër siç është përcaktuar në versionin e gjuhës shqipe të KPK-së, ndërsa në versionin në gjuhën serbe të KPK-së dispozita përkatëse nuk përmban elementin specifik të “sjelljes në Kosovë” të eksplozivëve. Parashtruesi i kërkesës konsideron se vetëm versionin në gjuhën serbe i ligjit duhet të zbatohet ndaj tij si serb.

33. Në fakt, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta ia kanë cenuar të drejtën e barazisë para ligjit lidhur me barazinë e gjuhëve zyrtare, të garantuar me nenet 5 dhe 24 (2) të Kushtetutës, pasi që ato “ndalojnë diskriminimin mbi këtë bazë.”

34. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet fakte dhe nuk dëshmon pretendimin mbi bazën e diskriminimit. Faktet dhe pretendimet e paraqitura mund të shihen, në esencë, nga perspektiva e parimit të legalitetit, të mbrojtur me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, si dhe me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit”.

36. Gjykata gjithashtu rikujton nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së, i cili parasheh:

“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare”.

37. Në fillim, Gjykata rikujton nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave të Drejtave të Njeriut] të Kushtetutës, *“të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.*
38. Në këtë drejtim, Gjykata më tej përkujton që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka përcaktuar parimet themelore të nenit 7 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 33 të Kushtetutës, veçanërisht në rastet *S.W. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 20166/92, Aktgjykimi i 22 nëntorit 1995, paragrafët 34-36: *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë*, kërkesat nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, Aktgjykimi i 22 marsit 2001, paragrafi 50: *Korbely kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 9174/02, Aktgjykimi i 19 shtatorit 2008, paragrafi 69.

Parimet themelore

39. GJEDNJ-ja ka përcaktuar që garancia e mishëruar në nenin 7 të KEDNJ-së është një element thelbësor i sundimit të ligjit dhe zë vend të shquar në sistemin e mbrojtjes të KEDNJ-së. Prandaj, objekti dhe qëllimi i tij kërkon që neni 7 të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë të tillë që të ofrojë mbrojtje efektive kundër ndjekjes, gjykimit dhe dënimit arbitrar. (Shih *Korbely kundër Hungarisë*, *Ibidem*, paragrafi 69).
40. Prandaj, neni 7 nuk kufizohet vetëm në ndalimin e zbatimit retrospektiv të së drejtës penale në dëm të një të akuzuari: gjithashtu mishëron më përgjithësisht parimin se vetëm ligji mund të përcaktojë një krim dhe të parasheh një dënim (*nullum crimen, nulla poena sine lege*) dhe parimin që e drejta penale nuk duhet të interpretohet gjerësisht në dëm të një të pandehuri, për shembull me anë të analogjisë. Nga këto parime rrjedh se një vepër penale duhet të përcaktohet qartë në ligj. Kjo kërkesë plotësohet kur personi mund të ketë dijeni nga formulimi i dispozitës përkatëse - dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të gjykatave dhe me këshillën juridike të informuar – se cilat veprime dhe mosveprime do ta vendosin atë nën përgjegjësi penale. Prandaj, Gjykata ka treguar se kur flitet për “ligjin”, neni 7 aludon (...) një koncept që përfshin ligjin e shkruar dhe atë të pashkruar dhe nënkupton kërkesat cilësore, veçanërisht ato të qasjes dhe parashikueshmërisë (Shih *Korbely kundër Hungarisë*, *Ibidem*, paragrafi 70).
41. Megjithatë, sado i qartë që të jetë formulimi i një dispozite ligjore, në cilindo sistem juridik, duke përfshirë edhe të drejtën penale, ekziston patjetër një element interpretimi gjyqësor. Do të duhet përherë të bëhet sqarim i pikave të dyshimta dhe përshtatje ndaj ndryshimeve të situatës (...). Neni 7 i Konventës nuk mund të interpretohet sikur e ndalon sqarimin shkallë-shkallë të

rregullave të përgjegjësisë penale përmes interpretimit gjyqësor nga një çështje të tjetra, me kusht që rezultati të jetë koherent me thelbin e veprës penale dhe i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme (shih *Jorgic kundër Gjermanisë*, nr. 74613/01, paragrafët 100-101, 12 korrik 2007; *Strelez, Kessler dhe Krenz*, cituar më lart, paragrafi 50, dhe *S.W. kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe C.R. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimet e 22 nëntorit 1995, Seria A. 335-B, fq. 41-42, paragrafët 34-36, dhe Seria A. 335-C, fq. 68-69, paragrafët 32-34). (Shih *Korbely kundër Hungarisë*, *Ibidem*, paragrafi 71).

42. Përveç kësaj, Gjykata përsërit se i takon kryesisht autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm. Roli i gjykatës kufizohet në konstatimin nëse ndikimet e këtij interpretimi janë të pajtueshme me Konventën (shih *Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 26083/94, paragrafi 54, ECHR 1999-I). (Shih *Korbely kundër Hungarisë*, *Ibidem*, paragrafi 72).

Zbatimi i parimeve të lartcekura në kërkesë

43. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se akti i sjelljes së eksplozivëve në Kosovë nuk ishte definuar si vepër penale në versionin serbisht të KPK-së në kohën kur është kryer vepra; sjellja e eksplozivëve në Kosovë, ai thekson, ishte përcaktuar vetëm si vepër penale në versionin në gjuhën shqipe të KPK-së.
44. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se ligji i cili ishte zbatuar për të nuk ishte mjaft i arritshëm dhe i parashikueshëm sepse versionin në gjuhën serbe nuk specifikonte qartazi se veprat që ai ka kryer ishin në fakt të përcaktuara si vepër penale.
45. Gjykata rikujton se parashtruesi e ngriti pretendimin e tij para Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë.
46. Gjykata Themelore mori parasysh parimin “*nullum crimen sine lege, nulla poena sine culpa*”. Ajo konsideroi se “i akuzuari ishte i vetëdijshëm se me veprimet e tij ai do të shkaktojë pasoja të ndaluara në vendin e huaj, pasoja të cilat me ligj janë parapara të jenë vepra penale”.
47. Gjykata e Apelit konsideroi se “ka ekzistuar dashja dhe vendosmëria e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale; kurse me asnjë provë nuk është konstatuar se ai ishte i detyruar ose nën kërcënim siç pretendohet nga mbrojtja; ndërsa gjykata e shkallës së parë ka ofruar arsye të mjaftueshme, në të cilin bazohej gjatë përcaktimit të ekzistimit të veprës penale”.
48. Gjykata Supreme në mënyrë specifike ka analizuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës se duhej të ishte zbatuar ligji në gjuhën serbe, që do të ishte më i favorshëm për parashtruesin e kërkesës.
49. Në të vërtetë, Gjykata Supreme vërejti se “këtu kemi të bëjmë me një, kryesisht të njëjtin ligj në dy gjuhë dhe në asnjë mënyrë nuk kemi të bëjmë me ligje të ndryshme siç thuhet në kërkesë”. Gjykata Supreme konsideroi që “Është fakt se

dispozita e nenit 144.3 të KPK-së përcakton se kushdo që dërgon apo bartë në apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës armë, eksploziv, helme, pajisje, municion apo material tjetër për kryerjen e një apo më shumë veprave penale (Kapitulli XIV) do të dënohet me burgim prej 5 deri 15 vjet, ndërsa në versionin në gjuhën serbe në të njëjtën dispozitë nuk figuron fjala “në” (... apo jashtë territorit të Kosovës ...). Domethënë, bëhet fjalë për një gabim teknik të përkthimit në gjuhën serbe, edhe pse kjo është dispozita e njëjtë e Ligjit 04/L-082, të datës 20.04.2012, i cili është në fuqi”.

50. *Për më tepër, Gjykata Supreme konkludoi se “i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale nga neni 144.3 në lidhje me nenin 135 paragrafi 1 pika 1.9 të KPK-së, prandaj dispozita e nenit 144.3 duhet të interpretohet në pajtim me pikën 1.9 të paragrafit 1 të nenit 135 të KPK-së, e cila ka të bëjë me veprat penale të parashikuara me nenet 372-377 (të Kapitullit XXX), të cilat përfshijnë importin, eksportin, furnizimin, transportimin, prodhimin e armëve dhe të cilat janë plotësisht në përputhje me dispozitën e njëjtë në versionin e kodit penal në gjuhën serbe”.*
51. *Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme mbështetet në tri shtylla: KPK është një dhe i njëjti ligj në dy gjuhë; fjala që mungon “në” (... ose jashtë territorit të Kosovës ...) në versionin serb është një gabim teknik i përkthimit në gjuhën serbe; dhe parashtruesi ishte shpallur fajtor për veprën penale të përcaktuar në nenin 144 (3), në lidhje me nenin 135 të KPK-së, i cili gjithashtu përcakton veprat penale përfshirë importin e eksplozivëve në Kosovë.*
52. *Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është dënuar në bazë të nenit 144 (3) në lidhje me nenin 135 të KPK-së. Si e tillë, marrëdhënia midis këtyre dy neneve e bën të qartë se importi, ose “sjellja në Kosovë”, e eksplozivëve është pjesë përbërëse e krimeve të përcaktuara si vepra terroriste. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu vë në dukje se versioni në gjuhën serbe i nenit 135 të KPK-së nuk dallon nga versioni në gjuhën shqipe.*
53. *Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se neni 135 [Përkufizimet për dispozitat e terrorizmit në nenet 121-145] të Kodit Penal [Ligji nr. 04/L-082) për Kodin Penal të Kosovës, parashikon:*

Për qëllime të neneve 121-145 të këtij Kodi:

1. Terrorizëm, veprim terrorist apo vepër e terrorizmit - kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare:

[...]

1.9. furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike në shkelje të neneve 176, 369 ose 372-377 të këtij Kodi;

54. Në këto rrethana, Gjykata përsërit se u takon kryesisht gjykatave të rregullta të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit; roli i Gjykatës është i kufizuar në konstatimin nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në dhe në parim nuk është detyrë e saj të zëvendësojë gjykatat e rregullta (shih *Korbely kundër Hungarisë, Ibidem*, paragrafi 72).
55. Gjykata rikujton që objekti dhe qëllimi i nenit 7 të KEDNJ-së është i përmbushur kur individit mund të dijë nga formulimi i dispozitave përkatëse - dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimit të gjykatave dhe me këshilla ligjore të informuara - cilat veprime do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht (Shih *Korbely kundër Hungarisë, Ibidem*, paragrafi 70).
56. Në të vërtetë, Gjykata përsërit se neni 7 i KEDNJ-së lejon sqarimin e rregullave të përgjegjësisë penale nëpërmjet interpretimit gjyqësor, me kusht që zhvillimi rezultues të jetë në përputhje me thelbin e veprës dhe mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme (Shih *Korbely kundër Hungarisë, Ibidem*, paragrafi 71).
57. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme konsideroi se ligji ishte mjaft i arritshëm dhe i parashikueshëm për parashtruesin e kërkesës para se të kryente veprat për të cilat ai ishte dënuar.
58. Në bazë të lartcekurave, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka vepruar në pajtim me juridiksionin e saj dhe efektet e interpretimit të saj ligjor janë në përputhje me Kushtetutën dhe me KEDNJ-në.
59. Për më tepër, Gjykata konsideron se i takonte parashtruesit të kërkesës që të dëshmojë pretendimin e tij se ai ishte dënuar padrejtësisht dhe në mënyrë arbitrare për kryerjen e një vepre që nuk ishte përcaktuar si vepër penale në versionin serbisht të KPK-së.
60. Prandaj, Gjykata konkludon se provat e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e justifikojnë pretendimin se ai ishte dënuar për kryerjen e veprave të cilat nuk janë përcaktuar si vepra penale në ligj, duke shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 33 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 7 (1) të KEDNJ-së.
61. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimi është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij mbi baza kushtetuese dhe as nuk ka treguar se vendimet e gjykatave të rregullta në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta apo arbitrare.
62. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendoi se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e tij për barazi para ligjit, siç garantohet me nenin 24 (2) të Kushtetutës.
63. Gjykatën, siç u arsyetua më lart, nuk e obligon kualifikimi ligjor i dhënë nga parashtruesi i kërkesës dhe rrjedhimisht i ka vlerësuar faktet dhe pretendimet e parashtruesit në dritën e nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 (1) të KEDNJ-së.

64. Kësisoj, Gjykata konsideron se nuk paraqitet ndonjë çështje shtesë dhe e veçantë në kuadër të nenit 24 të Kushtetutës.
65. Si përmbledhje, kërkesa nuk i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 113 (1 dhe 7) të Kushtetutës, të parashikuara me nenin 48 të Ligjit dhe të parapara me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (1 dhe 7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 janar 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi

